



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Radio Zëri i Shtimes
Pronar – Eljesa AHMETI
Radio ZËRI I SHTIMES
Rr/ e Prishtinës, Nr.217
Shtime

Ref:1609/963/KPM/am

V E N D I M

për ripërtëritjen e licencës së transmetimit të Radio Zëri i Shtimes, me seli në Shtime

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare.
2. Radio Zëri i Shtimes është subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në komunën e Shtimes, me seli në Shtime, regjioni i Prishtinës. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Zëri i Shtimes.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Zëri i Shtimes ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga KPM brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më 11 gusht 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e udhëzuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen, si dhe të kryej të gjitha obligimet ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.

1/2


5. Radio Zëri i Shtimes me datën 16 maj 2016, ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për të shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës.
6. Radio Zëri i Shtimes nuk ka obligime ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së.

Arsyvetimi

7. Radio Zëri i Shtimes ka vepruar pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke parashtruar kërkesën për ripërtëritje të licencës së KPM-së, e gjithashtu, ka kryer obligimet ndaj tarifës për licencë.
8. Vendimi i KPM-së (KPM V2-2016), i datës 8 shtator 2016, krijon bazën ligjore që të ripërtërijë licencën e kandidati të cilët kanë parashtruar kërkesën për ripërtëritje.
9. Duke marrë parasysh se Radio Zëri i Shtimes, ka vepruar në pajtim me udhëzimet e KPM-për të vepruar në pajtim me nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për KPM-në, KPM konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ripërtëritje të licencës së transmetimit për Radio Zëri i Shtimes.

V E N D I M

10. Komisioni merr VENDIM për ripërtëritjen e licencës së Radio Zëri i Shtimes, për të ushtruar veprimtari në ofrimin e shërbimeve mediale audio, me interes publik në zonën ku operon.
11. Licenca e transmetimit të KPM-së për Radio Zëri i Shtimes do të jetë e vlefshme në afat prej 7 (shtatë) viteve, bazuar në Nenin 21, paragrafin 2 të Ligjit për KPM-në, ndërsa, vlefshmëria e licencës do të llogaritet nga data 28 gusht 2016.
12. Të gjitha parametrat e licencës së KPM-së, si: Kategoria e të Licencuarit, Skema Programore, Parametrat Teknik si dhe Harta e Zonës së Mbulimit, mbesin të pandryshuara nga licenca paraprake.
13. Ky vendim hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të tij.


Adnan MEROVCI
Kryetar
Komisioni i Pavarur i Mediave



19.09.2016
Data

963

Lloji i dërgesës
Vista postiljke

Vlera e cekur - Shuma e dërguar
Oznaçona vlerdost - poslani iznos

nën numër
pod broj

ROVANO ZEKU SHAHIMES / EWESA AHMED
për
za
PE/E PRISHORINËS NR/217 SHATIME

(Vendi)
(Mesto)

01-10-2016

Poshtë i nënshkruarit deklarom që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë)
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marësit
Potpis bilježilaca

Vula e postës së vendit
Peçat pošte



Nënshkrimi i nënpunësit të postës së vendit
Potpis radnika pošte

